



AMF VAZHDON INSPEKTIMIN E PLANIFIKUAR PRANË BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT

Vijon në faqen 2

VËSHTRIM MBI TREGJET

Tregu i sigurimeve për periudhën janar-qershor 2012

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-qershor 2012 arritën shifrën 4,071,990 mijë lekë, përkundrejt 4,311,754 mijë lekë të realizuara në janar-qershor 2011.

Vijon në faqen 2

Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2012

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-qershor 2012 u dominua në masën 78.25% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari).

Vijon në faqen 5

EDUKIMI I KONSUMATORIT

Sigurimet dhe stabiliteti financiar

(Materiali është marrë dhe përpunuar nga faqja zyrtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve <http://www.iaisweb.org/>), botuar 2011).

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (International Association of Insurance Supervisors, IAIS) ka publikuar, më 15 nëntor 2011, një material të titulluar "Sigurimet dhe stabiliteti financiar", ku paraqitet këndvështrimi që kanë entet mbikëqyrëse të sigurimeve në lidhje me rolin e sektorit të sigurimeve dhe marrëdhënien që ka ky sektor me sistemin financiar dhe institucionet e tjera të tregut financiar.

Vijon në faqen 7

ZHVILLIME TË TJERA

Forumi financiar Paris
EUROPLACE: "Financimi, si
drejtimi kryesor për rritje"

3-4 korrik 2012

Forumi Paris EUROPLACE vendosi t'i kushtojë gjithë vëmendjen e tij Francës dhe Evropës, për të ruajtur aksesin në financime të ndërmarrjeve dhe më specifikisht atyre të sistemit të Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme, SME-ve.

Vijon në faqen 10

Çështjet thelbësore të mbikëqyrjes së sigurimeve

Instituti për Stabilitet Financiar (FSI), zhvilloi gjatë periudhës 15-20 korrik, në Beatenberg, Zvicër, seminarin e 8-të ndërkombëtar mbi çështjet thelbësore të mbikëqyrjes së sigurimeve.

Vijon në faqen 11

TË REJA NGA RAJONI

Të dhënat për tremujorin e parë, 2012

BOSNJE HERCEGOVINA

Vijon në faqen 13

KOSOVË

Vijon në faqen 13

SERBI

Vijon në faqen 12

SLLOVENI

Vijon në faqen 12

Inspektimi është fokusuar në mbikëqyrjen e veprimtarisë së BSHS-së, në funksion të zbatimit të detyrimeve ligjore që lidhen me trajtimin e dëmeve, objekt i Fondit të Kompensimit, si dhe procedurat për ndjekjen dhe arkëtimet nga Paditë e Regresit.

AMF VAZHDON INSPEKTIMIN E PLANIFIKUAR PRANË BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me qëllim realizimin e një prej objektivave të tij themelorë, mbrojtjen e vazhdueshme të konsumatorëve, po kryen një inspektim të plotë pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimit (BSHS). Ky inspektim, i cili ka filluar që prej datës 15 maj 2012, është ende në proces dhe synimi i zgjatjes së afateve të tij nga Autoriteti ka qenë realizimi i plotë i programit të inspektimit.

Periodha e inspektimit shtrihet që prej hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” duke përfshirë edhe praktikën e dëmeve që janë në proces trajtimi nga Byroja.

Inspektimi është fokusuar në mbikëqyrjen e veprimtarisë së BSHS-së, në funksion të zbatimit të detyrimeve ligjore që lidhen me trajtimin e dëmeve, objekt i Fondit të Kompensimit, si dhe procedurat për ndjekjen dhe arkëtimet nga Paditë e Regresit. Gjithashtu, qëllimi i këtij inspektimi është edhe zbatimi i detyrimeve ligjore që lidhen me administrimin e Fondit të Garancisë

së Kartonit Jeshil; përdorimin e tij në rast të mosshlyerjes së detyrimeve të anëtarëve të BSHS-së (shoqërive të sigurimit); rastet e mospërbushjes së detyrimeve financiare nga këta anëtarë ndaj Byrove/Shoqërive të huaja të raportuara nga Këshilli i Byrove; trajtimin e dëmeve ku shkaktarë janë mjetet me targa të huaja dhe zbatimin e Rregullores së Brendshme të Këshillit të Byrove për trajtimin e këtyre rasteve.

Autoriteti e ka pasur gjithnjë në vëmendje aktivitetin e Byrosë. Në prill të këtij viti Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi, zhvilloi një takim me drejtorët e shoqërive të sigurimit, anëtarë të Byrosë, për ecurinë e punës.

Aktualisht këto shoqëri kanë derdhur të gjithë kontributin e tyre në llogarinë qëllimore të Fondit të Kompensimit të planifikuar për vitin 2012 dhe pritet të sjellin propozimin për shtesë të këtij fondi për vitin në vazhdim.

Autoriteti do të vazhdojë të ndjekë me vëmendje punën e Byrosë dhe plotësimin e detyrimit të shoqërive në lidhje me Fondin e Kompensimit me synimin e tij themelor, mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Tregu i sigurimeve për periudhën janar-qershor 2012

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-qershor 2012 arritën shifrën 4,071,990 mijë lekë, përkundrajt 4,311,754 mijë lekë të realizuara në janar-qershor 2011 ose 5.56% më pak

se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 54.48% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 45.52% të tregut.



Gjatë kësaj periudhe ka patur një rënie në

masën 10.66% të primeve të sigurimeve të Jetës dhe një rënie prej 4.74% të primeve të sigurimeve të Jo-Jetës. Nga të ardhurat gjithsej të tregut, 88.63% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës, 11.26% nga veprimtaria e

Jetës dhe 0.10% nga veprimtaria e risigurimit.

Në janar-qershor 2012 u nënshkruan rreth 469,449 kontrata sigurimi, ose 25.40% më pak se në janar-qershor 2011.

Struktura e tregut të sigurimeve, për janar-qershor 2012




Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-qershor 2012 arritën shifrën 4,071,990 mijë lekë, përkundrajt 4,311,754 mijë lekë të realizuara në janar-qershor 2011

Volumi i primit të shkruar bruto, për janar-qershor 2012

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
	2011	2012
janar-qershor		
A) Sigurimi i Jetës	513,295	458,592
B) Sigurimi i Jo-Jetës	3,788,891	3,609,136
<i>Nga këto:</i>		
<i>a) Sigurimi i Detyrueshëm</i>	<i>1,905,230</i>	<i>1,853,508</i>
<i>b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)</i>	<i>1,883,662</i>	<i>1,755,628</i>
C) Risigurimi	9,568	4,262
TOTAL	4,311,754	4,071,990

Volumi i primit të shkruar bruto, për janar-qershor 2012 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Sigurimet e detyrueshme motorike

Në periudhën janar-qershor 2012, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 1,853,508 mijë lekë të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit MTPL e brendshme për periudhën janar-qershor 2012, arritën 1,413,586 mijë lekë, ose 24.26% më shumë se periudha janar-qershor 2011.

Në periudhën janar-qershor 2012, primet e shkruara bruto të Kartonit Jeshil ishin 315,702 mijë lekë, ose rreth 51.39% më pak se në janar-qershor 2011. Kjo ulje e primit të shkruar bruto në portofolin Karton Jeshil, lidhet me liberalizimin tregut të sigurimit të detyrueshëm në gusht të vitit 2011.


Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janar-qershor 2012 arritën në 124,220 mijë lekë, apo 5.14% më shumë se në janar-qershor 2011.

Sigurimet vullnetare

Për periudhën janar-qershor 2012, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 2,218,482 mijë lekë, ose 7.81% më pak se të ardhurat e janar-qershor 2011.

Sigurimet vullnetare të Jo-Jetës realizuan të ardhura 1,755,628 mijë lekë. Vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe dëme të tjera në pronë me 44.88%, të pasuara nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit me 19.70% dhe nga sigurimi kasko me 15.87%. Peshën më të ulët e patën sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile dhe sigurimi i garancisë.

Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, për janar-qershor 2012 (Jo-Jeta)



Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në periudhën janar-qershor 2012, arritën në 345,801 mijë lekë ose 32.05% më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e aksidenteve me 58.06% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e Jetës në periudhën janar-qershor 2012 arritën në 458,592 mijë lekë, ose 10.66% më pak se në janar-qershor 2011.


Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2012

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-qershor 2012 u dominua në

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: SIGAL UNIQA Group Austria, SIGMA VIENNA Insurance Group, INSIG, ATLANTIK, ALBSIG, INTERALBANIAN, Intersig Vienna Insurance Group dhe EUROSIG. SIGAL UNIQA Group Austria udhëhoqi tregun me 31.83% të primeve.

Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, për janar-qershor 2012 (Jeta)



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë SIGAL-LIFE UNIQA Group Austria, INSIG dhe SiCRED. SIGAL-LIFE UNIQA Group Austria udhëhoqi tregun me 41.81% të primeve.

Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në periudhën janar-qershor 2012 kapi vlerën 1,500,859 mijë lekë, ose 35.96% më shumë se në janar-qershor 2011. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 1,045,060 mijë lekë, apo 69.63% të totalit të dëmeve të paguara bruto.


masën 78.25% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (*bono thesari*) dhe pjesa tjetër prej 21.75% ishin

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për janar-maj 2012, arritën 1,144,241 mijë lekë, ose 24.07% më shumë se janar-maj 2011.

instrumente afatgjatë (*obligacione*). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 97% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2012, flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 42.67% dhe 31.65% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Letra me Vlerë të Qeverisë, janar-qershor 2012



- A - Blerje në tregun primar
- B - Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar
- C - Blerje nga individët para afatit të maturimit
- D - Vendosi e bonos si kolateral
- E - Shlyerje e vlerës nominale në maturim

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 98.12% të të gjitha transaksioneve në këtë treg, në raport me personat juridikë.

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar-qershor 2012 ka pasur një rritje prej 293.55 milionë lekë ose në masën 8.34% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kjo është shoqëruar me një ulje në masën 6.85% të numrit të transaksioneve.

Transaksioni i llojit C “Blerje nga individët para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar-qershor 2012 ka pasur një ulje prej 341.07 milionë lekë ose 20.68%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kjo është shoqëruar me një rritje në masën 2.04% të numrit të transaksioneve.

Krahasuar me periudhën janar-qershor 2011, vihet re një ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C, të marra së bashku, me rreth 47.52 milionë lekë.

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-qershor 2012 u dominua në masën 78.25% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe pjesa tjetër prej 21.75% ishin instrumente afatgjatë (obligacione).

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë 2011, 2012

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (në mln lekë)		Ndryshimi (në %)
	2011	2012	'12/'11-1
Letra me Vlerë të Qeverisë			
B Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	3,519.69	3,813.24	8.34
<i>Individë</i>	2,780.65	2,796.77	0.58
<i>Persona juridikë</i>	739.04	1,016.47	37.54
C Blerje nga individët para afatit të maturimit	1,649.49	1,308.42	(20.68)
<i>Individë</i>	811.24	766.37	(5.53)
<i>Persona juridikë</i>	838.25	542.05	(35.34)

EDUKIMI I KONSUMATORIT

Sigurimet dhe stabiliteti financiar

Materiali është marrë dhe përpunuar nga faqja zyrtare e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (International Association of Insurance Supervisors, IAIS <http://www.iaisweb.org/>), botuar 2011.

Kriza financiare e kohëve të fundit ka treguar se modeli tregtar tradicional i sigurimeve u ka dhënë mundësi shumë prej siguruesve t'i bëjnë mirë ballë krizës.

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (International Association of Insurance Supervisors, IAIS) ka publikuar, më 15 nëntor 2011, një material të titulluar “Sigurimet dhe stabiliteti financiar”, ku paraqitet këndvështrimi që kanë entet mbikëqyrëse të sigurimeve në lidhje me rolin e sektorit të sigurimeve dhe marrëdhënien që ka ky sektor me sistemin financiar dhe institucionet e tjera të tregut financiar.

Kriza financiare e kohëve të fundit ka treguar se modeli tregtar tradicional i sigurimeve u ka dhënë mundësi shumë prej siguruesve t'i bëjnë mirë ballë krizës. Në raport thuhet se risqet e nënshkruara të sigurimeve në shumicën e rasteve nuk janë të bashkëlidhura me ciklin tregtar ekonomik dhe me risqet e tregut financiar dhe se niveli i detyrimeve të sigurimeve, në përgjithësi, nuk preket nga humbjet e tregut financiar. Edhe pse janë prekur nga kriza financiare, siguruesit që merren me veprimtari tradicionale të sigurimeve nuk përbëjnë shqetësim, por nga këndvështrimi i riskut të sistemit.

Mirëpo, kriza financiare ka zbuluar se grupimet dhe konglomeratet e sigurimeve që ushtrojnë veprimtari në linjat tregtare tradicionale mund të pësojnë probleme të konsiderueshme dhe të fitojnë rëndësi për sistemin në nivel global kur zgjerohen në mënyrë të ndjeshme për t'u marrë me veprimtari jo tradicionale dhe jo të sigurimeve. Në material përshkruhet se si grupimet dhe konglomeratet e sigurimeve që merren me veprimtari jo tradicionale dhe jo të sigurimeve janë më pak të mbrojtura nga zhvillimet në tregjet financiare dhe, si të tilla, kanë më shumë të ngjarë ta zmadhojnë apo të kontribuojnë në riskun e sistemit. Shembuj të veprimtarive të tilla jo tradicionale dhe jo të sigurimeve përfshijnë veprimet me opsionet e këmbimit për kreditë e këqija (CDS) për qëllime që nuk janë mbrojtëse ose përdorimi i aktiveve si levë financiare për të rritur kthimin mbi investimin.

Peter Braumüller, Kryetar i Komitetit për Stabilitet Financiar të IAIS-it, prezantoi studimin edhe për panelet e konferencës dhe më pas median. Ai theksoi se: “Mesazhi kryesor i materialit tonë është se aktiviteti tradicional i sigurimeve përbën shumë pak ose aspak shqetësim për sistemin. Për këtë ka një sërë arsyes, siç janë flukset e qëndrueshme të primeve dhe mosvartësia të financimi afatshkurtër; apo flukset monetare që janë të parashikueshme për një periudhë kohore relativisht të gjatë. Të gjitha këto arsye bëjnë që veprimtaritë tradicionale të sigurimeve të mos ndikojnë në sistem”. Më tej shton se: “Në bazë të informacioneve të analizuar gjer më tani, për shumicën e linjave tregtare ka shumë pak informacion provues, se sigurimet tradicionale shkaktojnë apo e zmadhojnë riskun e sistemit brenda sistemit financiar apo në ekonominë reale. Mirëpo, entet mbikëqyrëse duhet t'i ndjekin nga afër ato veprimtari të sigurimeve që devijojnë nga modeli tradicional tregtar i sigurimeve”. Ai shton: “Kriza financiare ka treguar edhe se disa veprimtari të caktuara jo tradicionale mund të sjellin probleme, për shembull përdorimi në shkallë të gjerë i aktiveve si levë financiare (e ashtuquajtura “huadhënie e letrave me vlerë”) për të rritur kthimin e pritur nga investimet”. Mr. Peter Braumüller e cilëson këtë material si “... një piketë të rëndësishme në rrugën drejt kuptimit të gjithanshëm të rolit që luan sektori i sigurimeve në sistemin financiar dhe të marrëdhënies që ka me pjesëmarrësit e tjerë të tregjeve financiare. Përmbajtja e materialit do të kontribuojë edhe në diskutimin për hartimin e një metodike vlerësimi për identifikimin e siguruesve me rëndësi globale për sistemin”.

Sigurimet dhe stabiliteti financiar – përmbledhje e materialit

1. Në këtë material paraqitet këndvështrimi i mbikëqyrësve në lidhje me sektorin e (ri)sigurimeve dhe në lidhje me çështjet e stabilitetit financiar. Në të analizohet roli që

luan ky sektor në tregjet financiare, duke përfshirë edhe marrëdhënien që ka me institucionet e tjera financiare dhe efektin që ushtron mbi ekonominë reale. Krahas kësaj, Shoqata

Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) përpiqet të sqarojë logjikën ku mbështetet metodika që propozon kjo shoqatë për identifikimin e atyre institucioneve “dështimi i çrregullt i të cilave, për shkak të madhësisë, kompleksitetit dhe lidhjes së ngushtë që kanë me sistemin, do të shkaktonte një çrregullim të ndjeshëm në sistemin financiar dhe veprimtarinë ekonomike.”¹

2. Modeli i biznesit i ekspozon siguresit përpara risqeve të veçanta, të cilat zakonisht nuk i gjen në sektorin bankar. Për shembull, risqet e marrjes në sigurim siç janë risku i vdekshmërisë, i sëmundshmërisë, risku i pronës dhe risku i përgjegjësisë civile. Megjithatë, siguresit janë të ekspozuar edhe përpara risqeve që gjenden edhe në institucionet e tjera financiare, duke përfshirë riskun e kreditit, riskun e shfrytëzimit dhe riskun e tregut, të lidhura me investimet në kapitalin neto, si dhe me lëvizjet e normave të interesit dhe kursit të këmbimit. Edhe pse këto risqe nuk i përkasin vetëm sektorit të sigurimeve, ato mund të lindin në mënyra të veçanta në këtë sektor për shkak të modelit të veçantë tregtar që përdor ky sektor.

3. Kriza financiare e vitit 2008-2009 ka treguar se, në përgjithësi, modeli i biznesit tradicional i sigurimeve u ka dhënë mundësi shumicës së siguresve t’i bëjnë ballë krizës financiare më mirë se institucionet e tjera financiare. Kjo pasqyron faktin se risqet e marrjes në sigurim në përgjithësi nuk janë të bashkëlidhura me ciklin e biznesit

ekonomik dhe me risqet e tregut financiar dhe se niveli i rezervave teknike në përgjithësi, nuk preket nga humbjet e tregut financiar.² Gjithashtu, portofolet e investimeve të siguresve, të cilët përzgjidhen kryesisht për të përputhur tiparet e rezervave teknike, kanë qenë në gjendje t’i absorbojnë humbjet. Po kështu, natyra e rezervave teknike dhe fakti se pagesat që u bëhen policëmbajtësve në përgjithësi kërkojnë ndodhjen e ngjarjes së siguruar, e bën më pak të mundshme që siguresit e përfshirë në veprimtari tradicionale të pësojnë dalje të befasishme monetare që do t’i shteronin mjetet e tyre likuide. Edhe pse janë prekur nga kriza financiare, siguresit që merren me veprimtari tradicionale të sigurimeve kryesisht nuk kanë përbërë shqetësim, parë nga këndvështrimi i riskut të sistemit.

4. Megjithatë, grupimet dhe konglomeratet e sigurimeve që merren me veprimtari jo tradicionale dhe jo sigurimeve janë më pak të mbrojtura nga zhvillimet në tregjet financiare dhe (çka është më e rëndësishmja) kanë më shumë të ngjarë ta zmadhojnë apo të kontribuojnë në riskun e sistemit. Shembuj të veprimtarive jo tradicionale dhe jo të sigurimeve përfshijnë veprimet me opsionet e këmbimit për kreditë e këqija (CDS) për qëllime që nuk janë mbrojtëse ose përdorimi i aktiveve si levë financiare për të rritur kthimin mbi investimin. Krahas kësaj, tregu që zhvillohet gjithnjë e më shumë po

Kriza financiare e vitit 2008-2009 ka treguar se, në përgjithësi, modeli i biznesit tradicional i sigurimeve u ka dhënë mundësi shumicës së siguresve t’i bëjnë ballë krizës financiare më mirë se institucionet e tjera financiare.

1) Kjo ndjek përkufizimin e BSF-së në: “Ulja e rrezikut moral që vjen nga institucionet financiare me rëndësi për sistemin”, Bordi i Stabilitetit Financiar (BSF), tetor 2010. Metodika për të përcaktuar rëndësinë e mundshme për sistemin e grupeve dhe konglomerateve që përqendrohen te sigurimet ka të ngjarë të jetë e ndryshme nga qasja e ndjekur për sektorin bankar, për të pasqyrën natyrën e veçantë të veprimtarisë tregtare të sigurimeve.

2) Përjashtim përbëjnë disa linja të veçanta, siç janë sigurimi i hipotekave për huadhënësit, mbulimi për anëtarët e këshillit të administrimit dhe nëpunësit, sigurimi i kreditit dhe sigurimi i kreditit tregtar, apo disa veprimtari të caktuara e të përcaktuara si jo tradicionale në rubrikën 3.2 të këtij materiali, siç janë sigurimi i dorëzansë financiare, që për nga natyra janë të lidhura ngushtë me ciklin e biznesit dhe me paqëndrueshmërinë e tregjeve financiare.

Ashtu sikurse modeli i biznesit të sigurimeve dallon nga modeli bankar, ashtu ndryshon edhe efekti që ka rënia e institucioneve të sigurimeve të institucionet e tjera financiare dhe tek ekonomia reale.

nxjerr produkte dhe veprimtari që i fshijnë kufijtë midis veprimtarive tradicionale të sigurimeve dhe atyre të llojit bankar (apo të llojit të bankave të investimeve). Kriza financiare e kohëve të fundit ka treguar se grupimet dhe konglomeratet e sigurimeve financiarisht të fuqishme e që ushtrojnë veprimtari në linjat kryesore të biznesit tradicional mund të pësojnë probleme të konsiderueshme dhe të bëhen të rëndësishme për sistemin në nivel global kur zgjerohen në mënyrë të ndjeshme për t'u marrë me veprimtari jotradicionale dhe jo të sigurimeve. Në këtë kuadër, është e rëndësishme të bëhet dallimi midis atyre veprimtarive që janë të rregulluara, siç janë sigurimet dhe atyre që nuk janë të rregulluara.

5. Tregjet e sigurimeve i nënshtrohen konkurrencës. Edhe pse veprimtaria tregtare e sigurimeve konsiderohet se është kryesisht lokale, konkurrenca në shumicën e linjave tregtare, sidomos në ato të sigurimeve tradicionale, në përgjithësi është e fortë. Grupet e mëdha janë të ekspozuara përpara konkurrencës globale vetëm në lidhje me mbulimin e risqeve të mëdha. Këto dinamika tregojnë se zëvendësueshmëria, apo vijueshmëria e ofertës së mbulimit me sigurim pas rënies së një subjekti të vetëm, ka të ngjarë të ketë rëndësi më të vogël materiale në fushën e sigurimeve sesa në atë bankare.

6. Përjashtimet mund të lindin nëse ndodh të ketë përqëndrim të lartë të ofruesve në disa segmente të vogla dhe ekskluzive të tregut. Në segmentet monopoliste ose oligopoliste të tregut rënia e një

siguruesi mbizotërues mund të krijonte shtrembërime të përkohshme që do të ktheheshin në mungesë të ofertës për të mbuluar risqe me sigurime dhe në rritje të mëdha të çmimeve. Por, në përgjithësi, shtrembërime të tilla mbeten brenda tregjeve lokale dhe zgjasin një kohë të shkurtër. Janë vënë re edhe luhatje të konsiderueshme të çmimeve të sigurimeve të Jo-Jetës, pas humbjes së kapacitetit të shkaktuar nga katastrofat e mëdha natyrore. Por kapaciteti ka prirjen të rimëkëmbet shpejt. Rimëkëmbja e kapacitetit ndodh në përgjithësi pjesërisht me anë të marrjes së flukseve të reja hyrëse të kapitalit, duke qenë se pengesat në treg janë më të ulëta se në shumë linja të tjera tregtare. Kapaciteti i rimëkëmbur i ofertës në përgjithësi ushtron trysni nga lart poshtë mbi çmimet, dhe në shumicën e rasteve çmimet kthehen në nivelet e mëparshme.

7. Siguruesit lidhen me tregjet financiare nëpërmjet investimeve, gjetjes së kapitalit shtesë dhe sigurimit të borxhit. Në Evropë, grupet e sigurimeve i mbajnë një pjesë të konsiderueshme të investimeve në letra me vlerë të emetuara nga institucione të tjera financiare, kryesisht në formën e kapitalit dhe në shkallë më të vogël në formën e letrave me vlerë të kapitalit neto.³ Mundësia (dhe gatishmëria) e siguruesve për të bërë investime të tilla përbën një kontribut të rëndësishëm për stabilitetin financiar të bankave dhe të sistemit financiar në përgjithësi.⁴ Në mënyrë të ngjashme, siguruesit i kalojnë kapital edhe ekonomisë reale përmes blerjes së letrave me vlerë të borxhit të shoqërive industriale ose përmes investimeve në pasuri të palu-

3) "Risku i sistemit në fushën e sigurimeve: analizë e sigurimeve dhe stabilitetit financiar", Shoqata e Gjenevës, 2010.

4) Ky argument është trajtuar në një studim të Komitetit të Bazelit për Sistemin Global Financiar. shih: "Strategjitë e të ardhurave fikse të shoqërive të sigurimeve dhe fondeve të pensione". CGFS, qershor 2011. Duhet thënë se mbajtja e letrave me vlerë të borxhit të emetuara nga institucionet e tjera financiare ndryshon shumë nga njëri juridiksion të tjetrin.

ajtshme. Këto veprimtari theksojnë rëndësinë e një sektori financiarisht të shëndoshë dhe të qëndrueshëm të sigurimeve. Nga ana e tyre, veprimtaritë e investimeve i ekspozojnë siguruesit përpara paqëndrueshmërisë së sektorëve ku investojnë.

8. Ashtu sikurse modeli i biznesit të sigurimeve dallon nga modeli bankar, ashtu ndryshon edhe efekti që ka rënia e institucioneve të sigurimeve të institucionet e tjera financiare dhe tek ekonomia reale.

Arsyet e këtyre dallimeve sa i takon efektit kanë të bëjnë me veçantitë e modelit tregtar të sigurimeve, me zbatimin e disiplinuar të një qasjeje për investimet kryesisht të orientuar nga detyrimet, me natyrën e dëmeve që, në shumë raste mundësojnë administrimin e flukseve dalëse monetare gjatë një periudhe të gjatë kohore (nga javë në muaj e deri në vite, në varësi të linjës tregtare) dhe me nivelin e lartë të zëvendësueshmërisë, që mundëson një lehtësi relative të hyrjes në treg në shumicën e linjave tregtare.

9. Përgjigja për pyetjen nëse do të shkaktonin apo jo risk të sistemit siguruesit mbetet në fund të fundit një problemë empirike.

Por, në bazë të informacioneve të analizuar gjer më tani, për shumicën e linjave tregtare ka shumë pak informacion provues se sigurimet tradicionale shkaktojnë apo e zmadhojnë riskun e sistemit brenda sistemit financiar apo në ekonominë reale. Sigurisht, vlerësimet empirike për rëndësinë që kanë siguruesit dhe grupimet e sigurimeve për sistemin mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Një historik pozitiv nuk e garanton mungesën e mundësisë për risk të sistemit në të ardhmen. Kjo është arsyeja përse IAIS është e angazhuar ta shqyrtojë rregullisht ritmin e novacioneve dhe ndryshimeve në

modelet tregtare të sigurimeve, si dhe në marrëdhëniet komplekse brenda grupeve të sigurimeve. IAIS do të vazhdojë edhe me analizën e rolit që luajnë risiguruesit në kuadër të stabilitetit financiar.

10. Dallimet mes siguruesve dhe bankave, sa i takon efektit të rënies së institucioneve, ndër të tjera bëjnë të ditur se kërkesat për absorbimin e humbjeve dhe regjimet e likuidimit për siguruesit duhet t'i pranojnë këto dallime të rëndësishme dhe të propozojnë zgjidhje që bëjnë dallimin e duhur. Në shumicën e juridiksioneve, mbikëqyrësit tashmë kanë në dorë një gamë të gjerë zgjidhjesh për monitorimin dhe zbatimin me forcë të kërkesave ligjore për kapitalin dhe provizionet për siguruesit tradicionalë dhe kanë metodika të sprovuara për mbikëqyrjen e siguruesve në proces falimentimi. Në të ardhmen e afërt, do të analizohet më me hollësi efekti i veprimtarive tregtare jo të sigurimeve dhe jotradicionale në grupet e sigurimeve. Nëse do të gjykohej e nevojshme, rezultatet e analizës do të pasqyrohen në Standardet e IAIS-it në lidhje me regjimet e falimentimit dhe, sipas rastit, ka të ngjarë të bëhen rekomandime për absorbimin e humbjeve.

11. Gjatë këtyre viteve të fundit, IAIS i ka rritur përpjekjet për promovimin e mbikëqyrjes për të gjithë grupet. Në kuadër të rishikimit të Parimeve Qendrore të Sigurimeve (ICP), që janë publikuar për herë të parë në vitin 2003, IAIS e ka përmirësuar materialin mbikëqyrës që trajton mbikëqyrjen e siguruesve në bazë të gjithë grupit, duke përfshirë edhe materialin në lidhje me bashkëpunimin

dhe bashkërendimin si në nivel ndërkuftar ashtu edhe në nivel ndërsektorial, si edhe në lidhje me trajtimin e subjekteve të parregulluara në mbikëqyrjen e të gjithë grupit. ICP-të e rishikuara janë miratuar më 1 tetor 2011.

12. IAIS ka nisur gjithashtu punën për përgatitjen e një kuadri të përbashkët për mbikëqyrjen e grupeve të shoqërive të sigurimeve me aktivitet ndërkombëtar (ComFrame). Ky kuadër i përbashkët u drejtohet rreth 50 grupeve të sigurimeve që i përmbushin kriteret për t'u quajtur grupeve të shoqërive të sigurimeve me aktivitet ndërkombëtar (IAIG) sipas

përkufizimit të IAIS-it. Ky kuadër ka si qëllim për ta vënë në funksionim mbikëqyrjen e të gjithë grupit përmes trajtimit të risqeve përpara të cilave janë të ekspozuara këto institucione. Kuadri i përbashkët trajton si këndvështrimin e mbikëqyrësit të gjithë grupit ashtu edhe të mbikëqyrësit të vendit pritës, përmes përcaktimit të roleve për bashkëpunim dhe ndërveprim, duke përfshirë edhe ngritjen e kolegjeve mbikëqyrëse.

Kjo ishte përmbledhja ekzekutive e studimit, ndërsa i gjithë studimi gjendet në faqen zyrtare të IAIS-it <http://www.iaisweb.org/Other-papers-and-reports-46>

ZHVILLIME TË TJERA

Forumi financiar Paris EUROPLACE: “Financimi, si drejtimi kryesor për rritje”

Në datat 3–4 korrik 2012 u zhvillua në Paris takimi i radhës i forumit *Paris EUROPLACE, Financial Forum* me temë “Një marrëveshje e re për Francën dhe Evropën: Financimi, si drejtimi kryesor për rritje”. Në këtë takim mori pjesë edhe z. Mati Pepa, nënkryetar i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Forumi *Paris EUROPLACE* vendosi t'i kushtojë gjithë vëmendjen e tij Francës dhe Evropës, për të ruajtur aksesin në financime të ndërmarrjeve dhe me specifikisht atyre të sistemit të Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme, SME-ve. Ky ishte edhe mesazhi që dha z. Gerard Mestrallet, kryetar i forumit *Paris EUROPLACE*. Forumi diskutoi edhe impaktin që do të kenë mbi bankat dhe shoqëritë e sigurimit zbatimin e udhëzimeve të Basel 3 dhe Solvency 2.

Ndër temat dhe prezantimet kryesore që u prezantuan në forum ishin: Reforma



në tregjet financiare: si ta optimizojmë financimin e ekonomisë; Ribalancimi i rritjes ekonomike në Evropë; Tregjet financiare: Drejt një hierarkie të re të risqeve; Financimet afatgjata dhe financimet publike; Marrëdhënia financiare dhe psikologjia e investitorëve; Ndërtimi i financimeve të qëndrueshme: cilat janë prioritetet e radhës; Optimizimi i strukturave të tregjeve: Drejt tregjeve të fuqishme dhe eficiente të kapitaleve në Evropë.

Veprimet me përparësi sipas Forumit *Paris EUROPLACE* duhet të jenë:

- Përhshpejtimi i ndërtimit të një platforme burse për SME-të;
- Vënia në zbatim e mjeteve të reja për kompanitë, duke përfshirë këtu edhe

Veprimet me përparësi sipas Forumit Paris EUROPLACE duhet të jenë:

- Përhshpejtimi i ndërtimit të një platforme burse për SME-të;
- Vënia në zbatim e mjeteve të reja për kompanitë, duke përfshirë këtu edhe SME-të, që do t'u mundësojë atyre financimin nëpërmjet tregut të letrave me vlerë.

SME-të, që do t'u mundësojë atyre financimin nëpërmjet tregut të letrave me vlerë.

Përveç seksioneve kryesore, Forumi *Paris EUROPLACE* zhvilloi edhe seksione paralele me tema më specifike

për tregjet financiare dhe të kapitaleve.

Forumit *Paris EUROPLACE* i këtij viti ishte edicioni i 19-të i takimeve vjetore të këtij forumi i cili u ndoq nga 1500 profesionistët të fushës së financave nga e gjithë Evropa.

Seminar i 8-të ndërkombëtar

Çështjet thelbësore të mbikëqyrjes së sigurimeve

Instituti për Stabilitet Financiar (FSI), zhvilloi gjatë periudhës 15-20 korrik, në Beatenberg, Zvicër, seminarin e 8-të ndërkombëtar mbi çështjet thelbësore të mbikëqyrjes së sigurimeve. Në këtë takim të përvitshëm morën pjesë 26 përfaqësues nga shtete të ndryshme të botës. Seminari u zhvillua në formën e një tryeze të rrumbullakët interaktive, që synonte diskutimet në grup, shkëmbimin e ideve e perspektivave të ndryshme lidhur me mbikëqyrjen, dhe u përqendrua në trajtimin e disa prej çështjeve thelbësore të mbikëqyrjes. Disa nga temat me interes që u trajtuan në këtë seminar përmendim:

- Roli i Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) dhe i standardeve ndërkombëtare;
- Mbikëqyrja me fokus makro dhe rreziku sistemik;
- Menaxhimi i riskut dhe roli i risigurimit;
- Kapitali (Solvency) dhe metodat cilësore e sasiore të vlerësimit të riskut të sigurimeve;
- Mbikëqyrja në nivel grupi dhe bashkëpunimi i rregullatorëve të shteteve ku ushtron aktivitet grupi;
- Vlerësimi i provigjoneve teknike bazuar në standardet e IAIS-it dhe qasja bazuar në bilanc shoqëruar me shëmbuj konkret;



Pjesëmarrës të seminarit të 8-të ndërkombëtar mbi çështjet thelbësore të mbikëqyrjes së sigurimeve

- Mësimet e marra nga kriza financiare dhe roli i qeverisjes së korporatave;
- Menaxhimi i riskut të korporatave dhe përllogaritja e kapitalit rregullator me qasje riskun.

Temat kryesore, u prezantuan nga drejtues të nivelit të lartë të FSI-së dhe IAIS-it, si dhe profesionistë të tjerë të fushës. Secila prej temave të trajtuara ndiqej nga një rast studimor, i cili diskutohet dhe prezantohet nga pjesëmarrësit, të cilët ishin të ndarë në grupe pune. Ndër temat që u analizuan dhe u prezantuan nga pjesëmarrësit ishin: (i) rast studimor lidhur me kriteret e licencimit të një shoqërie sigurimi, (ii) rast studimor lidhur me mbikëqyrjen e grupit ku u theksuan mjaftueshmëria e kapitalit të grupit, qeverisja e tij dhe menaxhimi i rrezikut në nivel grupi, (iii) rast studimor mbi identifikimin e hershëm të shoqërive të sigurimit me paqëndrueshmëri financiare dhe analizimin e shkaqeve si pasojë e së cilave një shoqëri sigurimi rrezikon falimentimin. Gjithashtu, lektori përfaqësues

Ndër temat që u analizuan dhe u prezantuan nga pjesëmarrësit ishin : (i) rast studimor lidhur me kriteret e licencimit të një shoqërie sigurimi, (ii) rast studimor lidhur me mbikëqyrjen e grupit ku u theksuan mjaftueshmëria e kapitalit të grupit, qeverisja e tij dhe menaxhimi i rrezikut në nivel grupi, (iii) rast studimor mbi identifikimin e hershëm të shoqërive të sigurimit me paqëndrueshmëri financiare dhe analizimin e shkaqeve si pasojë e së cilave një shoqëri sigurimi rrezikon falimentimin.

i Autoritetit Mbikëqyrës Australian (APRA) prezantoi rastin e falimentimit të kompanisë së dytë më të madhe të sigurimit në Australi, “HIH”, i konsideruar si falimentimi më i madh në historinë e Australisë. Pjesëmarrësit të organizuar

në grupe pune, në përfundim të seminarit realizuan një sërë prezantimesh rreth çështjeve të ndryshme të procesit të mbikëqyrjes, si mbikëqyrja me bazë risku dhe mbikëqyrja me fokus makro.

TË REJA NGA RAJONI

Të dhënat për tremujorin e parë, 2012

BOSNJE HERCEGOVINA

<http://www.xprimm.com/>

Gjatë periudhës janar-mars 2012, totali i primeve në Bosnje e Hercegovinë kapi vlerën prej 59.7 milionë Euro ose 0.34% më pak, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2011.

Gjatë periudhës janar-mars 2012, totali i primeve në Bosnje e Hercegovinë kapi vlerën prej 59.7 milionë Euro ose 0.34% më pak, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2011. Në strukturën e primeve totale, pjesa e shoqërive të regjistruara në Federatën e Bosnje Hercegovinës ishte 75.59%, ndërsa ato të regjistruara në Republikën Serbe të Bosnjes 24.41%. Këto të dhëna u deklaruan si rezultate financiare kumulative të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Federatës së Bosnje Hercegovinës (NADOS) dhe nga Agjencia e Sigurimeve të Republikës

Serbe të Bosnjes (AZORS).



Në totalin e primit të shkruar bruto, segmenti i sigurimit të Jetës kapi vlerën e 10.2 milionë Euro, ndërsa pjesa prej 49.6 milionë euro i përket sigurimeve të Jo-Jetës. Për sa i takon dinamikës, sigurimet e Jo-Jetës regjistruan një rënie prej 1.6%, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2012, ndërsa sigurimet e Jetës shënuan një rritje prej 6.6%.

KOSOVË

<http://www.xprimm.com/>

Sipas të dhënave zyrtare të publikuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, dëmet e paguara nga siguruesit kapën vlerën e 6.5 milionë Euro.

Në periudhën janar-mars 2012, primet e shkruara bruto të shoqërive të sigurimit në Kosovë u rritën me 2.9%, duke kapur vlerën prej 18 milionë Euro, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kjo vlerë u arrit nga rreth 130 mijë polica të shitura gjatë kësaj periudhe. (Krahasuar me rreth 104 mijë polica të shitura në tremujorin e parë të 2011).

siguruesit kapën vlerën e 6.5 milionë Euro.



Në fund të muajit mars, sigurimi MTPL pati rënie me 5.8% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke kapur vlerën 9.8 milionë Euro. Në të njëjtën kohë, policat kufitare arritën vlerën totale prej 2 milionë Euro, pothuajse dyfishi në vlerë absolute me atë të vitit të kaluar.

SERBI<http://www.xprimm.com/>

Bazuar në të dhënat financiare të publikuara nga Banka Qendrore e Serbisë (NBS), gjatë tremujorit të parë të vitit 2012, Primet e Shkruara Bruto në Serbi u rritën me 3.89%, sidomos si pasojë e rritjes së policave të sigurimit të Jetës.

Gjatë periudhës janar-mars 2012 primet në total arritën vlerën 14.9 bilion RSD (Dinari serb) afërsisht 128 milionë Euro. Në këtë total primet në sigurimin e Jetës janë rritur me 11.2% dhe sigurimet e Jo-Jetës me 2.5%.

Në tregun e sigurimeve Serbe u shtuan

dhe dy kompani të tjera, që prej vitit të kaluar AXA Nezivot dhe kompania ruse SOGAZ Osiguranje – licencuar në dhjetor 2012. Nga 28 kompanitë që veprojnë në tregun e sigurimeve gjatë këtij viti, 24 prej tyre janë të angazhuara në sigurime, ndërsa katër të tjera vetëm në risigurim. Nga të gjitha kompanitë e sigurimit, shtatë janë ekskluzivisht për sigurimin e Jetës, njëmbëdhjetë ekskluzivisht për sigurimin e Jo-Jetës, ndërkohë gjashtë kompani përfshijnë sigurimin e Jetës dhe të Jo-Jetës së bashku.



Gjatë periudhës janar-mars 2012 primet në total arritën vlerën 14.9 bilion RSD (Dinari serb) afërsisht 128 milionë Euro.

SLLOVENI<http://www.xprimm.com/>

Gjatë periudhës janar-mars, primet në kompanitë e sigurimit sllovene kanë pësuar rënie me 1.5%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar duke arritur në afro 574 milion Euro.

Më shumë se një e katërta e totalit të tregut ose rreth 150.7 milionë Euro, u sigurua nga segmenti i Sigurimit Motorik (TPL dhe Kasko) dhe rreth 84 milionë Euro i përkasin sigurimit të pronës.

Sipas të dhënave financiare të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve Sllovene (Slovenian Insurance Association, SIA), 19 siguruesit, anëtarë të SIA raportuan një volum total në dëme prej 376 milionë Euro, ose 14.5% më shumë krahasuar me

tremujorin e parë të vitit 2011 dhe kjo kryesisht për shkak të rritjes prej 186% të kontratave të sigurimit të Jetës.

Kompania e sigurimit Zavarovalnica TRIGLAV mbetet lider në tregun Slloven, me një total në prime prej 198 milionë Euro, që përfaqëson 34.5% të totalit të primeve të shkruara. TRIGLAV pasohet nga Zavarovalnica MARIBOR me një ndarje tregu prej 14.7% ose 84.16 milionë Euro në prime. ADRIATIC Slovenica renditet e treta me prime që shkojnë 67.8 milionë Euro, ndërkohë VAZJEMNA renditet e katërta me prime që shkojnë rreth 67.5 milionë Euro.



Më shumë se një e katërta e totalit të tregut ose rreth 150.7 milionë Euro, u sigurua nga segmenti i Sigurimit Motorik (TPL dhe Kasko) dhe rreth 84 milionë Euro i përkasin sigurimit të pronës.

Për këtë numër punuan:

R. Guri, D. Kalaja, E. Kodra, R. Eltari, E. Beqir-Aga, E. Kokona

